




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/34 datë: 31.01.2024

Bazuar në nenin 12.2. pika (c), nenin 40.2 pika (g), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Neneve 10 deri në 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe duke u bazuar në nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë Npi – 01/205 datë: 14.07.2017; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 31.01.2024 moratoi këtë:

V E N D I M

**PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
PROPOZIM-RREGULLOREN KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA
PËR VITIN 2024**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 31.01.2024, unanimitisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2024. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi